



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 21.06.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2024, të vazhduar me datën 18.06.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 77, të datës 21.05.2024, të Drejtorisë së Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin para - universitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 6 paragrafi 1, 2, 3 dhe nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues para - universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 8, të Rregullores për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale nr. 125, të datës 25.09.2014 mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të pesë Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.
 - 1.1 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim për Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Lismiri', në fshatin Lismir në përbërje prej tre anëtarëve:
 - 1.1.1 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
 - 1.1.2 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.1.3 Gëzim Berisha - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti', në fshatin Graboc i Poshtëm;
 - 1.1.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
 - 1.1.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.1.6 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.

1.2 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', në Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:

- 1.2.1 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
- 1.2.2 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
- 1.2.3 Esad Simnica - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti', në fshatin Graboc i Poshtëm;
- 1.2.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
- 1.2.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
- 1.2.6 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.

1.3 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët – Shkolla e re në Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:

- 1.3.1 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
- 1.3.2 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
- 1.3.3 Salih Jashanica - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Zenel Salihu', në fshatin Bardh i Madh;
- 1.3.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
- 1.3.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
- 1.3.6 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.

1.4 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim e Institucionit Parashkollorë 'Gëzimi Ynë' Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:

- 1.4.1 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
- 1.4.2 Elmije Grajçevci Zymberi - Shefe e Drejtorisë së Arsimit - Kryetare e Komisionit;
- 1.4.3 Nexhmedin Rexhepi - anëtar i Komisionit Zëvendës drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi II, në Fushë-Kosovë;
- 1.4.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
- 1.4.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe
- 1.4.6 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.

1.5 Për zgjedhjen e Komisionit për rekrutim në Institucionin Parashkollorë për Çerdhen e re në Fushë-Kosovë në përbërje prej tre anëtarëve:

- 1.5.1 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit;
- 1.5.2 Elmije Grajçevci Zymberi - Shefe e Drejtorisë së Arsimit - Kryetare e Komisionit;
- 1.5.3 Sadri Emimi - anëtar i Komisionit Zëvendës drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi I në Fushë-Kosovë;
- 1.5.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në nivel komune;
- 1.5.5 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve - në cilësinë e vëzhguesit dhe

1.5.6 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve - në cilësinë e vëzhguesit.

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

